

V E N D I M
Nr. 630, datë 12.11.2001

**PËR VENDOSJEN E KUFIZIMEVE NË SHITJEN E MALLRAVE NË MAGAZINAT
DOGANORE TË TIPIT "C", "DUTY FREE SHOPS"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 82 të ligjit nr.8449, datë 27.1.1999 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", ndryshuar me ligjin nr.8473, datë 14.9.1999 me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1.Magazinat doganore të tipit "C" , "Duty free shops" lejohen t'u shesin mallin duhan dhe produktet e tij vetëm udhëtarëve mbi moshën 15 vjeç, që kalojnë territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, në bazë të kufizimit sasior për çdo udhëtar, si më poshtë vijon:

- i) dy steka cigare;
- ii) 100 cigarillo (cigare me peshë maksimale prej 3 gramë secila);
- iii) 100 puro;
- iv) 250 gramë duhan.

2.Magazinat doganore të tipit "C" , "Duty free shops" lejohen t'u shesin mallin pije alkoolike, verë dhe birra, vetëm udhëtarëve mbi moshën 18 vjeç që kalojnë territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, në bazë të kufizimit sasior, për çdo udhëtar, si më poshtë vijon:

dy litra pije të distiluara dhe alkool me fortësi alkoolike ndaj volumit më të lartë se 22 për qind ose alkool etilik i padenaturuar me forcë alkoolike ndaj volumit 80 për qind dhe më shumë;

(ii) 3 litra pije të distiluara dhe alkool, aperitivë me bazë vere ose alkooli ose pije të ngjashme me fortësi alkoolike ndaj volumit që nuk i kalon 22 për qind ose verë të gazuar, likere;

(iii) 3 litra verë të zakonshme.

3.Ngarkohen Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta